



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr. 45, datë 26 / 03 /2026

PËR

**‘DHËNIE TRUALLI PËR NDËRTIMIN E AMBULANCAVE NË FSHATRA
POLENË, PULAHË, GJONBABAS DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË
BASHKËPUNIMIT SIPAS MATERIALIT BASHKËNGJITUR’**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërma a) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njërive të vetëqeverisjes vendore”, dhe Kodin Civil

VENDOSI:

1. Të vendosë në dispozicion të Shoqatës Gjysmëhëna e Kuqe, pasuritë :
 - Nr. 88/2, ZK. 3016, ndodhur në fshatin Polenë, Njësia Administrative Voskop ;
 - Nr. 86/4, ZK 3071, ndodhur në fshatin Pulahë, Njësia Administrative Mollaj ; dhe
 - Nr. 35/2, ZK. 1756, ndodhur në fshatin Gjonbabas, Njësia Administrative Lekas, me qëllim ndërtimin mbi këto pasuri të objekteve, Ambulanca të Tipit A-2.
2. Të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit sipas tekstit bashkëngjitur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 26-03-2026

